



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2709/10 prot.

Datë 10.01.2023

V E N D I M
Nr. 18 / 2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.01.2023, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 2709/2022 prot., datë 05.12.2022 për procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-43438-09-26-2022, me objekt: “Loti 6 “Stenta të medikuara” me fond limit me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 103,707,450 (njëqind e tre milion e shtatëqind e shtatë mijë katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, fondi limit ne euro 891,570 Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 27.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ankimues:

Operatori ekonomik “GP Medical AL” SHPK
Adresa: Vorë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Rruga e Kavajës, nr. 1001, Tiranë

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e*

rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.09.2022, është publikuar në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, SPE, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-43438-09-26-2022, me objekt: “Loti 6 “Stenta të medikuara” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 103,707,450 (njëqind e tre milion e shtatëqind e shtatë mijë katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, fondi limit ne euro 891,570 Euro pa TVSH zhvilluar në datën 27.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

II.2. Në datën 05.12.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është depozituar ankesa me nr. 2709 protokolli e operatorit ekonomik “GP Medical AI” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës

lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij, si dhe duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “OES Distrimed” SHPK. Bazuar në nenin 112, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi në datën 05.12.2022 “Formularin për Publikim” Nr. 2709/2 prot., datë 05.12.2022.

II.3. Në datën 09.01.2023, operatori ekonomik ankimues “GP Medical Al” SHPK, me anë të shkresës protokolluar me tonën me nr. 2709/9 prot., datë 09.01.2023, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-43438-09-26-2022, me objekt: “Loti 6 “Stenta të medikuara” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 103,707,450 (njëqind e tre milion e shtatëqind e shtatë mijë katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, fondi limit ne euro 891,570 Euro pa TVSH zhvilluar në datën 27.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik “GP Medical Al” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-43438-09-26-2022, me objekt: “Loti 6 “ Stenta të medikuara” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 103,707,450 (njëqind e tre milion e shtatëqind e shtatë mijë katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, fondi limit ne euro 891,570 Euro pa TVSH zhvilluar në datën 27.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë, para përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit

nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës nr. 2709/2022, datë 05.12.2022 për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-43438-09-26-2022, me objekt: “Loti 6 “Stenta të medikuara” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 103,707,450 (njëqind e tre milion e shtatëqind e shtatë mijë katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, fondi limit në euro 891,570 Euro pa TVSH zhvilluar në datën 27.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “GP Medical AI” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri